



Agjencia e Mbikëqyrjes Policore

JANAR 2023

Agjencia ka marrë masa dhe ka siguruar kushtet për të zbardhur dhe administruar ankesat e ardhura në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga publiku, si dhe ankesa e shqetësime të adresuara nëpërmjet institucioneve të tjera të administratës publike apo nga media vizive dhe ajo e shkruar.

Të gjitha ankesat e reja regjistrohen në Sistemin e Menaxhimit të Çështjes, për t'u ndjekur në vijim, në kohë reale, në përputhje me ligjin dhe procedurat standarde të punës për trajtimin e ankesave.

MËNYRAT E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT

Për ankesa ndaj strukturave objekt i veprimtarisë




ankesa@amp.gov.al



0800 90 90

Për denoncime në kuadër të Vetingut në Polici



denonco@amp.gov.al



Rr. "Asim Vokshi", Nr. 19/1, Tiranë


Për t'u paraqitur në zyrat tona



Zyra e Pritjes së Qytetarëve në
Drejtorinë e Përgjithshme

Zyrat e Drejtorive Rajonale pranë
DVP-ve në Qarqe

Për t'u informuar rreth AMP, na ndiqni



www.amp.gov.al



VEPRIME HETIMORE

Referimet e bëra në Prokurori

12 referime në Prokurori për **12** punonjës të Policisë së Shtetit, **1** punonjës i MZSH dhe **4** shtetas për vepra të ndryshme penale.

Arrestuar/ndaluar në flagrancë

1 punonjës i MZSH i arrestuar në flagrancë

Ekzekutimet e vendimeve të dhëna nga Prokuroria/Gjykata

- Vendosur masa e sigurimit "Pezullim i ushtrimit të një shërbimi publik":**
3 punonjës policie

INSPEKTIVE/VENDIME

Gjatë muajit Janar janë kryer **6** inspektive, nga të cilat ka rezultuar se për **3** punonjës, Policisë së Shtetit i është rekomanduar fillimi i hetimit disiplinor për "Shkelje të lehtë".

Komisioni Disiplinor ka shqyrtuar në total **9** praktika disiplinore për muajin Janar, nga të cilat në 4 raste ka konstatuar dhe vendosur fillimin e hetimit disiplinor për **5** punonjës policie, ndërsa në 5 raste ka konstatuar dhe vendosur mosfillimin e hetimit disiplinor si më poshtë:

- Në 1 rast, për **1** punonjës policie është vendosur dhënia e masës disiplinore "Përfundim nga Policia e Shtetit"
- Në 1 rast, për **1** punonjës policie është vendosur dhënia e masës disiplinore "Shtyrje të afatit të gradimit për 1 vit"
- Në 1 rast, për **1** punonjës policie është vendosur përfundimi i hetimit disiplinor pasi është njohur me vendimin e DPPSH për "Dhënie mase disiplinore" dhe "Shtyrje të afatit të gradimit për 2 vite"
- Në 1 rast, për **1** punonjës policie është vendosur mosfillimi i hetimit disiplinor dhe është rekomanduar hetim disiplinor për "Shkelje të lehtë"
- Në 4 raste, për **4** punonjës policie, AMP është njohur me vendimin e DPPSH për "Dhënie mase disiplinore" dhe "Përfundim nga Policia e Shtetit"
- Në 1 rast, për **1** punonjës policie, është vendosur fillimi i hetimit disiplinor

HETIME ADMINISTRATIVE TË ANKESAVE

Zyra e pritjes së qytetarëve dhe komunikimi me publikun




278 Telefonata

në linjën e gjelbër **08009090**, nga të cilat:

118 telefonata brenda objektit të veprimtarisë së AMP
(Në ndjekje nga strukturat përgjegjëse të Agjencisë)

52 telefonata jashtë objektit të veprimtarisë së AMP
(Adresuar strukturave të administratës publike për ndjekje)

108 telefonata i është dhënë informacioni sipas rastit
(Qytetarët janë orientuar drejt strukturës kompetente të administratës publike që trajton ankesat e tyre)



Ankesa të trajtuara

Ky grup nënkupton përfundimin e trajtimit të ankesës dhe kthimin e përgjigjes për qytetarin.

95 ankesa



Ankesa të administruara

Administrimi nënkupton regjistrimin e çdo ankese, pavarësisht nëse duhet të ndiqet nga Agjencia apo një institucion tjetër i Administratës Publike. Ankesat administrohen në Sistemin e Menaxhimit të Ankesave, ku secila merr një numër unik.

80 ankesa